

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER
AKTIVITETIN:**

"PERPUNIMI I METALEVE FERROSE"

(Per prodhimin e Tralice, Zgara, Tel i zinguar,
Tel i vijeziuar ne rote, Tel bari, Hekur i holluar
i vijeziuar, Gozhdet e ndertimit)

Vendodhja :Lagja 14, Shkozet, Durrës

Kërkues: Subjekti: "Perparimi" sh.a

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Tetor, 2017

Pasqyra e lendes:

1	PERMBLEDHJE.....	2
1.1.	Hyrje.....	2
1.2.	Karakteristikat e projektit, te dhena te pergjitheshme.....	3
2	KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR PER VNM.....	3
2.1	Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.....	3
2.2	Kuadri ligjor kombetar.....	4
2.3	Permbledhje e kuadrit ligjor.....	4
3	PERSHKRIM I MJEDISIT EKZISTUES.....	6
3.1.	Pershkrim i pergjithshem per Qarkun Durres.....	6
3.1.1	Bashkia e Durresit.....	6
3.1.2	Popullsia dhe aktivitet kryesore ekonomike te zones.....	7
4	PERSHKRIMI I PROJEKTIT.....	0
4.1.	Te pergjithshme mbi aktivitetin.....	0
5.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE.....	7

1 PERMBLEDHJE

1.1. Hyrje

Legjislacioni kombetar, direktivat europiane te fushes se mjedisit dhe konventat nderkombetare, ne te cilat vendi yne eshte pale, parashetrojne kerkesa qe synojne mbrojtjen e shendetit human dhe mbrojtjen e mjedisit si nje te tere.

Trajtimi i integruar, kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në një mënyrë të përforcuar reciprokisht. Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit te shfrytëzimit të mjedisit dhe mbrojtjes së tij. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë së tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, do të çojnë në një rritje të madhe të kostos së përgjithshme te zhvillimit ekonomik.

Objekti i raportit te permbledhjes joteknike TE Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis te projektit **“Perpunimi i metaleve Ferrose**, per prodhimin e Tralice, Zgara, Tel i zinguar, Tel i vijeziuar ne rrote, Tel bari, Hekur i holluar i vijeziuar, Gozhdet e ndertimit”, me vendodhje ne Lagjen 14, Shkozet, Durres. eshte:

- përcaktimi, përshkrimi dhe vleresimi i ndikimeve të pritshme mjedisore të zbatimit të projektit.
- propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.

Ortofoto e zones ne vleresim



1.2. Karakteristikat e projektit, te dhena te pergjitheshme

Shoqëria “Perparimi” Sh.a, me NIPT. J81906504A, me seli ne Durres L.14 SHKOZET dhe me administrator Z. Petrit Hasanaj, ka si qellim funksionimin e aktivitetit “Perpunimi i metaleve Ferrose, per prodhimin e Tralice, Zgara, Tel i zinguar, Tel i vijeziuar ne rrote, Tel bari, Hekur i holluar i vijeziuar, Gozhdet e ndertimit. Ky aktivitet eshte i pajisur me pare me leje mjedisore me nr PN-5844-07-2013, por duke iu referuar Ligjit nr.10448, dt 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, Kreu VI Dispozitat Kalimtare dhe te Fundit, Neni 30 Dispozita te Perkohshme per Instalimet ekzistuese te tipit A dhe B , Operatori i instalimit duke mos aplikuar brenda 2 viteve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji per Rishikim te kushteve te lejes ekzistuese Mjedisore, tani referuar ligjit duhet te aplikojte per leje te re mjedisore .

2 KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR PER VNM

2.1 Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje shtate normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojte zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegjel kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojte zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

2.2 Kuadri ligjor kombetar

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojte, parashikojte dhe parandaloje ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafuar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM paraprake. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

2.3 Permbledhje e kuadrit ligjor

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”

“PERPUNIMI I METALEVE FERROSE”

- Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Vendim i Kshillit te Ministrave nr 909, date 21.12.2016 “Per rikuperimin e avujve te benzines ne fazen e dyte gjate mbushjes se mjeteve motorrike ne stacionet e shitjes se karburanteve “.
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”
- Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”
- Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e afateve per zhvilimin e procedures se VNM-se dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore”
- Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.

3 PERSHKRIM I MJEDISIT EKZISTUES

3.1. Pershkrim i pergjithshem per Qarkun Durres

3.1.1 Bashkia e Durrësit

Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Kurbin, Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.



Harta e re territoriale e bashkisë Durrës

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Durrësi ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë një të rëndësishme tregtare në vend.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

3.1.2 Popullsia dhe aktivitet kryesore ekonomike te zones

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km² ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km².

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Bashkia Durrës

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	175,110	299,989	338.3
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori			
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjurica, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,			
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik			
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj,			
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kamas, Radë, Shkallë, Fshat Manëz			

Durrësi ka portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njën më të rëndësishme tregtare në vend.

Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës.

Në sektorin e prodhimit, 45% e ndërmarrjeve zhvillojnë aktivitet në industrinë ushqimore, ndërsa pjesa tjetër prej 55% në industrinë e lehtë. Në industrinë ushqimore aktivitet kryesore janë furrat e bukës, përpunimi i mishit (prodhim sallamesh e proshutash), prodhimi i birrës, kantinat e verës, fabrikat e miellit dhe prodhimit të brumrave etj.

Industria e lehtë përfshin aktivitete të tilla si prodhim veshmbathje dhe këpucë, prodhime alumini, prodhim kimikatesh, industri e përpunimit dhe riciklimit të letrës, prodhim i lëndëve larëse.

Kompanitë e tjera zhvillojnë aktivitete në fushën e turizmit, ndërtimit, tregtisë dhe komunikacionit. Sipas të ardhurave që realizojnë, 829 prej tyre konsiderohen si aktivitete të biznesit të madh.

Ndër kompanitë më të mëdha që zhvillojnë aktivitet në rrethin e Durrësit renditen AIBA kompani (prodhim i vezëve dhe një ndër më të mëdhatë në vend me aktivitet edhe në tregjet lokalë), kantina e pijeve alkolike Gjergj Kastrioti Skënderbeu, SUCRALBA (përpunim dhe paketim artikujsh ushqimorë si sheqer, oriz, makarona etj.), ALBMAR (përpunim peshku, eksportuese produktesh), TEUTA EB, ALBI F etj.

Porti i Durrësit mbulon rreth 85% të import-eksporteve shqiptare të mallrave dhe pjesën më të madhe të transportit detar të udhëtarëve. Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha llojet e mallrave

minerale, karburante, çimento dhe artikuj të kategorive të ndryshme. Në port gjendet dhe terminali i trageteve.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

4 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

4.1. Te pergjithshme mbi aktivitetin

Shoqëria "Perparimi" Sh.a, eshte themeluar ne vitin 1994, ka me shume se dy dekada qe operon ne fushen e materialeve te ndertimit. I pozicionuar ne pike kyce te transportit kryesore te gjithe Shqiperise ne Shkozet, Durres vetem 1 km nga Porti i Durresit i cili eshte edhe porti me madh ne vend.

Lenden e pare e cila eshte hekuri i ndertimit, subjekti e siguron nga vendet e certifikuara europiane, me ane te se cilet prodhon te gjitha produktet e tjera si: Zgara Hekuri, Tralice (Kapriata), Gozhde Ndertimi, Tel Celiku i djegur (Tel Bari), Tel Xingato. Tel i vijeuar ne rrote, Hekur i holluar i vijeuar.

Pamje e ambjenteve te aktivitetit



Pershkrimi i skemes teknologjike

Objekti ne fjale destinohet si aktivitet per “PERPUNIM TE METALEVE FERROSE” , per prodhimin e Tralice, Zgara, Tel i zinguar, Tel i vijezuar ne rrote, Tel bari, Hekur i holluar i vijezuar, Gozhdet e ndertimit, ku :

1. **Tralice**, prodhohet me material te rrumbullaket e te vjaskuar prej celiku te markes SAE 1008 dhe SAE 1010. Perdoret ne ndertim. Klasifikimi i Tralices ne baze te formes:

- Me gjatesi nga 1 m deri ne 12 m
- Me diameter teli fi 4.0 mm; fi 5.0 mm ; fi 5.5 mm; fi 6.0 mm; fi 6.5 mm; fi 7.0 mm

Cilesite e Tralices:

- Perberje kimike e materialit celik, prodhohet nga material celik i standartit SAE 1008; SAE 1010
- Forma dhe perberja e traut
- Kufiri i qendrushmerise dhe perberja kimike sipas standartit SAE 1008; SAE 1010. Tel i terhequr ne te ftohte
- Ambalazhimi behet ne pako nga 50 cope
- Ne ambalazh vendoset etiketa me permbajtje:
 - *Shoqeria Prodhuese*
 - *Pesha neto*
 - *Data e prodhimit*
 - *Firma e kontrollorit te cilesise*

Pamje te makinerise te prodhimit te Tralices



2. **Zgara**, prodhohet me material te rrumbullaket e te vjaskuar prej celiku te markes SAE 1008 dhe SAE 1010. Perdoret ne ndertim. Klasifikimi i Tralices ne baze te formes:

- Ne gjatesi dhe gjeresi 5.0 m x 2.0-2.5 m dhe 6.0 m x 2.0-2.5 m.
- Ne permasat e kuadratit 200 mm x 200 mm; 200 mm x 250 mm; 250 mm x 300 mm; dhe 250 mm x 250 mm; 150 mm x 150 mm; 100 mm x 100 mm.
- Ne diameter teli fi 4.0 mm; fi 5.0 mm; fi 5.5 mm; fi 6.0 mm; fi 6.5 mm; fi 7.0 mm.

Cilesite e Zgares:

- Perberje kimike e materialit celik, prodhohet nga material celik i standartit SAE 1008; SAE 1010
- Forma dhe perberja e rrjetes.
- Kufiri i qendrueshmerise dhe perberja kimike sipas standartit SAE 1008; SAE 1010. Tel i terhequr ne te ftohte
- Ambalazhimi behet ne pako nga 50 cope ose 100 cope
- Ne ambalazh vendoset etiketa me permbajtje:
 - *Shoqeria Prodhuese*
 - *Pesha neto*
 - *Data e prodhimit*
 - *Firma e kontrollorit te cilesise*

Pamje te makinerise te prodhimit te Zgares



3. **Tel i Zinguar**, sherben per prodhimin e rrjetes Gabion, per lidhje te ndryshme, prodhohet prej celiku te markes SAE 1008 dhe SAE 1010. Klasifikimi i Telit te Zinguar behet ne baze te formes:

- Ne gjatesi nga 0.6 mm deri ne 2.2 mm Gjatesi eshte ne fokuson te kerkeses se klientit

Cilesite e Telit te Zinguar:

- Shmangia nga forma rrethore e telit dhe shtrese te zinguar jo me shume se 0.2-0.6 mikron
- Kufiri i qendrueshmerise dhe perberja kimike e telit sipas standarteve: SAE 1006 dhe SAE 1008
- Ne te gjithe siperfaqen e telit nuk lejohen demtime, keputje dhe ndryshk
- Telit i behet prova me keputje sipas rekomandimeve te standartit SAE 1006 dhe SAE 1008
- Ne ambalazh vendoset etiketa me permbajtje:
 - *Shoqeria Prodhuese*
 - *Pesha neto*
 - *Data e prodhimit*
 - *Firma e kontrollorit te cilesise*

Pamje te makinerise te prodhimit te Telit te Zinguar



4. **Tel i Vijeuar ne rrote**, prodhohet me material celiku te rumbullaket dhe qe vjaskohet te standartit SAE 1008 dhe SAE 1010. Klasifikimi i Telit te Vijeuar ne Rrote sipas permases prodhohet ne permasat: fi 5.0 mm ; fi 5.5 mm; fi 6.0 mm; fi 6.5 mm; fi 7.0 mm; fi 7.5 mm.

Cilesite e Telit te Vijeuar ne Rrote:

- Forma e rumbullaket dhe vijeziimi sipas kerkeses
- Kufiri i qendrueshmerise dhe perberja kimike sipas standartit SAE 1008 dhe SAE 1010. Tel i Terhequr ne te ftohte
- Ne gjithe siperfaqen dhe gjatesine nuk lejohen demtime

Ambalazhimi dhe marketimi

Ambalazhimi behet ne rulon me fi 600 mm – 700 mm dhe ne peshe, ne funksion te diametrit te telit te kerkuar dhe ne peshe me funksion te diametrit te telit te kerkuar afersisht 1200 kg-1500 kg

Ne rulon ngjitet etikete me permbajtje :

- *Shoqeria Prodhuese*
- *Pesha neto*
- *Data e prodhimit*
- *Firma e kontrollorit te cilesise*

Pamje te makinerise te prodhimit te Telit teVijeuar ne Rrote



5. **Tel Bari**, prodhohet me material celik, i rrumbullaket, catange, i markes SAE 1006, SAE 1008, SAE 1010. Perdoret ne industrine e ndertimit dhe me perdorim te gjere per efekte lidhese

- Sipas madhësisë ndahet në permasa nga 0.95 mm deri në 5 mm.

Cilesite e Telit te Barit:

- Diametri i telit të jete në permasat: fi 0.95 mm deri në 5.0 mm
- Kufiri i qëndrueshmërisë të jete Rm (Mpa) i barabartë ose më i vogël se 400 si dhe përberja kimike e telit sipas standartit SAE 1006, SAE 1008 dhe SAE 1010.
- Siperfaqja e telit të jete e lemuar, e pa djegur dhe pa ndryshk
- Ambalazhimi bëhet në 2 kg, 5 kg, 10 kg apo dhe në peshë të tjera sipas kërkesës së porositesit
- Në çdo pako 1000 kg etiketa ka të saktësuar:

- *Shoqëria Prodhuese*
- *Pesha neto dhe bruto*
- *Data e prodhimit*
- *Firma e kontrollorit të cilësive*

Pamje të makinerisë të prodhimit të Telit të Barit



6. **Hekur i Holluar i vijeziuar**, prodhohet me material të rrumbullaket e të vajskuar prej celakut të markes SAE 1008 dhe SAE 1010, perdoret në ndërtim. Produkti sipas formës ndahet:

- Me gjatësi nga 1 m deri në 12 m
- Me diametër teli fi 4.0 mm; fi 5.0 mm; fi 5.5 mm; fi 6.0 mm; fi 6.5 mm, fi 7.0 mm; fi 8.0 mm

Cilesite e hekurit të holluar të vijeziuar:

- Përberja kimike e materialit celik, prodhohet nga material celik i standartit SAE 1008; SAE 1010
- Forma dhe përberja e traut
- Kufiri i qëndrueshmërisë dhe përberja kimike sipas standartit SAE 1008; SAE 1010. Tel i terhequr në të ftohtë
- Ambalazhimi bëhet në pako nga 50 cope

Ne ambalazh vendoset etiketa me permbajtje:

- Shoqeria Prodhuese
- Pesha neto
- Data e prodhimit
- Firma e kontrollorit te cilesise

Pamje te makinerise te prodhimit te Telit te Barit



7. Gozhdet e Ndertimit, prodhimi i te cilave behet nga celiqe te markave SAE 1008; SAE 1010 ose ASTM-510 m. Perdoren ne Industrine e Ndertimit

Permasat e gozhdeve te ndertimit

Nr	Emertimi i gozhdes	d	D	h	L
1	fi 2.50 x 50	2.5	5.20	1.5	50
2	fi 2.86 x 60	2.86	6.	1.7	60
3	fi 3.1 x 70	3.1	6.5	1.8	70
4	fi 3.5 x 80	3.5	7.2	2.1	80
5	fi 3.5 x 90	3.5	7.2	2.1	90
6	fi 4.0 x 110	4.0	8.2	2.4	110
7	fi 4.0 x 120	4.0	8.2	2.4	120

Cilesite e Gozhdeve te Ndertimit:

- Kufiri i qendrueshmerise sipas standartit RM (Mpa) e barabarte ose me e vogel se 400, tel i terhequr ne te ftohte
- Koka e gozhdeve duhet te jete e rrumbullaket dhe simetrike ne varesi me trupin . Siperfaqe e kokes duhet te kete viza ne forme rombi (godron) ose katrore.
- Trupi i gozhdes duhet te jete i drejte, lejohet nje shtremberim prej 0.05 mm-0.1 mm per gozhdet me gjatesi 50 mm; 0.2 mm- 0.4 mm per gozhdet me gjatesi 60 mm-80 mm dhe 0.5 mm-0.8 mm per gozhdet 100 mm te larta
- Maja e gozhdeve duhet te kete formen e nje piramide trekendore, e cila nuk duhet te kete teprime pas prerjes. Veshe, teprime ne majen e gozhdes lejohen deri ne 4 %

- Siperfaqja e trupit duhet të jetë e lëmuar, pa gërvishje dhe pa ndryshk. Në koken e trupit mund të ketë maja të kapjes së nofullës shtrenguese. Lejohen vetëm disa viza të thelluara dhe shenja të dhënesit
- Gozhdeve u bëhen prova në perkulje dhe terhqje

Ambalazhimi:

Gozhdet e ndertimit ambalazhohen në kuti kartoni, 5 kg dhe në ambalazh plastik me 20 kg.

Vendosen në paleta druri deri në 1200 kg

Cdo kuti ka të stampuar:

- *Shoqeria Prodhuese*
- *Pesha neto*
- *Data e prodhimit*

Ruajtja dhe transporti:

Ruajtja e gozhdeve bëhet në mjedise të thata, pa lagështi dhe lagë lendeve kimike gërryese.

Transportimi i gozhdeve bëhet nga bleresi

Pamje të makinerisë të prodhimit të Gozhdeve të ndertimit



5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe linjes teknologjike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Ndikimet e pritshme ne mjedis te analizuara gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliohen si me poshte:

1. Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Pastrimi i ambjenteve te aktivitetit
- b) ujrat e perdorura per qellime sanitare.

Lidhur me ujrat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrat industriale, por duhet te kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e qytetit.

Duke respektuar procesin teknologjik, mundesite e ndotjes nga ujerat e shkarkimit do te jene zero.

2. Ndotja e tokes Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk kemi ndikime ne toke. Procesi I prodhimit te produkteve per ndertim nuk kryhet ne te thate, dhe me terheqje ne te ftohte pa perdorur energji elektrike. Nga ky aktiviteti gjenerohet nje sasi e vogel skoriesh celiku te cilat subjekti I dergon per shkrirje ne fabrikat e fonderive.

3. Ndotja e ajrit vjen gjate procesit te levizjes se automjeteve te cilat furnizojne subjektin me lende te pare dhe nga automjetet te cilat marrin produktet perfundimtare te cilat prodhohen ne kete kompani.

Siguria dhe ndikimet e pritshme ne shendet shkaktohen nga:

1. Rreziku nga **zjarri**
2. Rreziqet nga **aksidentet industriale**

Si cdo aktivitet tjeter industrial edhe ne kete rast, megjithe shkallen e sigurise qe ka vete dizenjimi i impiantit, masat e sigurise te marra nga kompania jane te domosdoshme, per te evituar rreziqet ne mjedis dhe shendet qe vijne nga zjarri per shkak te aksidenteve. Me poshte jane evidentuar edhe masat e mundeshme per te evituar dhe minimizuar rreziqet nga incidentet e ndryshme. Per kete subjekti duhet te

“PERPUNIMI I METALEVE FERROSE”

zbatoje kushte te larta sigurie. Te vendosen postera sensibilizues dhe te njihet nga punetoret rregullorja e kushteve te sigurise gjate punes ne kete objekt.